



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: KUVENDI
Nr. 2278 Prot Datë 06 / 06 / 2022

Shkurtimi i lëndës: Dergim rezolute

Për trajtim nga:			
<input type="checkbox"/> KËSHILLTARI	<input type="checkbox"/> KOORDINATORI	<input type="checkbox"/> DR.MBIKËQYRJES	<input type="checkbox"/> DR.PF & TIK
<input checked="" type="checkbox"/> KABINETI	<input checked="" type="checkbox"/> DR.JURIDIKE	<input type="checkbox"/> DR.SHERB.BREND.	<input type="checkbox"/> DR.PROGRAMEVE
<input type="checkbox"/> K.ANKESAVE	<input type="checkbox"/> DR.BNJMJ		
Me porosi:			

Afati: Urgjent (brenda ditës) | Prioritet (3 ditë) | Normal (7 ditë) | Pa afat/ per dijen | Tjetër __ ditë

Data ____ Nr. Prot ____

Nënshkrimi (TITULLARI) _____

Marrë në dorëzim: ____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: ____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Marrë në dorëzim: ____ Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (specialisti): _____

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më : ____

Trajtimi i materialit pranuar më: ____

Trajtimi i materialit miratuar më: ____

Trajtimi i materialit miratuar më: ____

Specialisti
Eprori në shkallë hirearkike
Eprori në shkallë hirearkike
Eprori në shkallë hirearkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1317/2 Prot.

Tiranë më 03.06.2022

Lënda: Dërgim rezolute

AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2021”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONÇAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

K R Y E T A R E

Lindita NIKOLLA



REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT
TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2021**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke theksuar se reagimi i OSHMA-ve edhe gjatë vitit 2021 ka vijuar të jetë i menjëhershëm dhe efikas në zbatim të kërkesave ligjore për rastin e pandemisë së COVID-19, duke përcjellë disa herë në ditë mesazhet e përgatitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Duke theksuar faktin se prej muajit mars 2021 AMA e ka ushtruar aktivitetin administrativ vetëm me 4 anëtarë, situatë e cila krijoi një ngërç në punën e saj për shkak të pamundësisë për miratimin e vendimeve, të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar (5 vota);

Duke theksuar gjithashtu se pandemia globale COVID-19 ka ndikuar në performancën e OSHMA-ve duke dhënë efekte në strukturën dhe katalogun e përmbajtjeve të emetuara, në burimet njerëzore të angazhuara, në treguesit ekonomikë dhe financiarë, ku u reduktuan ndjeshëm të ardhurat nga reklamat, promovioni etj.,

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e AMA-s për vitin 2021 dhe vlerëson:

Autoritetin e Mediave Audiovizive, e cila për herë të parë që nga themelimi, 21 vjet më parë, u angazhua në monitorimin e mbulimit medietik nga OSHMA-të të fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të datës 25 prill 2021. Raportet e AMA-s nuk patën asnjë kundërshtim të gjetjeve prej operatorëve audio dhe audiovizivë e në të njëjtën kohë shërbyen si burim reference për raportet e monitoruesve vendas dhe ndërkombëtarë.

Punën e bërë gjatë pandemisë së COVID-19 për nxitjen dhe ndërgjegjësimin e OSHMA-ve, që të ishin bashkëpunuese me autoritetin shëndetësor publik në transmetimin e mesazheve informuese për qytetarët dhe institucionet, të nevojshme për parandalimin e përhapjes së

koronavirusit, për njohjen me masat dhe protokollet e mbrojtjes dhe kurimit të rasteve të infektimit.

Punën e bërë për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit me AKEP-in, i cili ndër të tjera përcakton bashkëpunim në çështje me rëndësi, si: lufta kundër paligjshmërisë në transmetimet audiovizive, lirimi i brezit 700 MHz (brezi DD2), ndjekja në vijueshmëri të problemeve me interferencat etj.

Punën e bërë nga Këshilli i Ankesave, i cili ka shqyrtuar 300 ankesa (kundrejt 123 ankesave në vitin 2020 dhe 90 në vitin 2019); rritja e numrit të ankesave që nga krijimi i tij në vitin 2016 tregon problematikat me të cilat përballet ky sektor.

Punën e bërë në procesin e monitorimit të përmbajtjeve audiovizive të transmetuara, me fokus të veçantë reklamën për medikamentet, emisionet për shëndetin, duke iu përgjigjur interesit për mbrojtjen e qytetarëve nga abuzimet me transmetimet për këtë temë, si dhe mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme.

Punën e bërë për nxitjen dhe mbështetjen e politikave për rregullimin e mjedisit medietik, edukimin e gazetarëve të rinj, si dhe bashkëpunimin me grupet e interesit në fushën e medias.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 rekomandon që AMA të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimtarisë së saj:

1. Menjëherë pas finalizimit të procesit të lirimit të brezit DD2 në fund të qershorit 2022, të fillojë nga puna me procesin e rishikimit të tarifave për t'i dhënë zgjidhje problemit të tarifave të mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së nga operatorët lokalë, duke pasur parasysh edhe rëndësinë që ka në funksion të interesit publik vijueshmëria e transmetimeve televizive të televizioneve lokale, të cilat janë thelbësore për zhvillimin e demokracisë dhe përfaqësimin e komuniteteve të ndryshme në sferën publike të një vendi.

2. Gjatë punës për rishikimin e Kodit të Transmetimit të bashkëpunojë me të gjithë aktorët dhe faktorët përkatës, përfshi edhe organizatat ndërkombëtare, si: OSBE, KiE, etj., për të bërë të mundur që Kodi i ri i Transmetimit të jetë sa më në koherencë me sfidat dhe zhvillimet në fushën e medias, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë mbrojtjes së fëmijëve përmes parandalimit të promovimit në emisione apo programe audiovizive të fenomenit të bullizmit, abuzimit seksual, dhunës fizike e verbale etj.

3. Të propozojë ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e legjislacionit për reklamën publike në përputhje me standardet ndërkombëtare.

4. Duke qenë se, siç theksohet edhe në raportprogresin e fundit të KE-së, transparencën e financimit të medias mbetet një objektiv kyç për të përmirësuar lirinë e medias në vend, AMA një ndër objektivat kryesore të punës së saj të ketë forcimin e mbikëqyrjes lidhur me çështjet e pronësisë dhe kontrollit të OSHMA-ve.

5. Si një institucion me ekspertizën e duhur teknike të japë kontributin e saj gjatë fazës së rishikimit në Kuvend të ndryshimeve ligjore të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si për sa i takon krijimit të një kuadri rregullator për mediet online, si një realitet i ri në industrinë medietike, ashtu edhe të adresimit të opinionit të Komisionit të Venecias, për të bërë të mundur që këto ndryshime të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe parimet e lirisë së medias.

6. Të koordinojë punën edhe me institucionet e tjera që duhet të kontribuojnë për të bërë të mundur transpozimin e pjesshëm brenda vitit 2022 të Direktivës së BE-së 2010/13/BE "Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë", për mbrojtjen e fëmijëve, reklamën, juridiksionin, aksesueshmërinë e personit me aftësi të kufizuara etj.

7. Në bashkëpunim me AKEP-in, OSHEE-në dhe Shoqatën e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë dhe Valorë të punojë për gjetjen e rrugëzgjdhjeve lidhur me problematikën e heqjes nga shtyllat elektrike të kabllorëve të operatorëve kabllorë.

8. Të vijojë të ndjekë çdo ankesë të qytetarëve apo grupeve të interesit, duke i vlerësuar me seriozitet ato. Fakti që numri i ankesave pranë Këshillit të Ankesave që nga krijimi i tij në vitin 2016 ka pasur një rritje progresive nga viti në vit tregon për rritjen e besimit tek Autoriteti në funksion të interesit publik në transmetimet audiovizive.

9. Të vijojë të kërkojë marrjen e hapave konkretë e të shpejtë në lidhje me zgjidhjen e problemit të mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave duke theksuar që zgjidhja e kësaj çështjeje është një detyrim që garanton të drejtën e informimit dhe mjaft e ndjeshme për “komunitetin me nevoja të veçanta shqisore”.

10. Të punojë për rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit si rregullator nëpërmjet zbatimit të proceseve dhe procedurave që janë të hapura e të kontrollueshme, si dhe duke lehtësuar barrën burokratike për subjektet që Autoriteti licencon/autorizon.

11. Të vijojë të luajë një rol proaktiv në bashkëpunimin me aktorët dhe faktorët përkatës për të bërë të mundur forcimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punës dhe sociale të gazetarëve si një çështje që ka ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias dhe kërkesë e përsëritur në raportprogreset e KE-së.

12. Të analizojë me përgjegjësi raportet ndërkombëtare, të cilat lidhen me lirinë e medieeve në Shqipëri, dhe të trajtojë me seriozitet problematikat që kanë të bëjnë me aktivitetin e Autoritetit.

13. Të jetë më proaktive në rastet e dhunimit verbal ose fizik në krye të detyrës të gazetarëve, si dhe në çdo rast që cenohet integriteti moral ose fizik i gazetarëve.

14. Të monitorojë intensivisht dhe në vijimësi veprimtarinë e RTSH-së për përmbushjen e detyrimeve të tij si televizioni publik kombëtar dhe si një institucion që financohet me taksat e publikut shqiptar.

Miratuar në datën 23.5.2022